



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 782 Prot.

Tiranë, më 24.11 2015

VENDIM Nr. 113, datë 18.11.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.14, të datës 18.11.2015, pasi shqyrtoi Relacionin mbi gjetjet në Amfiteatrin e Durrësit, në kuadër të projektit "*Rehabilitimi i hapësirës së Amfiteatrit*", paraqitur nga IMK dhe DRKK Durrës, dhe pas verifikimit në terren nga grupi i punës me përfaqësues të KKA, KKR, IA, ASHA dhe DRKK Durrës,

VENDOSI:

- I. Të ruhen dhe konsolidohen muret e amfiteatrit të zbuluara gjatë zbatimit të projektit "*Rehabilitimi i hapësirës së Amfiteatrit*".
- II. Të kryhet dokumentimi i fragmentit të murit të banesës së shek.XIX-XX dhe më pas të vijojë çmontimi i kësaj strukture për çlirimin e hapësirës së amfiteatrit, sipas projektit të sipërpërmendur.
- III. Të mos realizohet në këtë fazë të projektit "*Rehabilitimi i hapësirës së Amfiteatrit*" çmontimi i portës monumentale në formë "hark triumfi" dhe frontonit të zbukuruar me ornamente floreale.
- IV. Gjatë zbatimit të punimeve të kryhet mbikqyrja arkeologjike nga DRKK Durrës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al